

AKTAKUZAT NË MUNGESË PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË

BULETIN | SHKURT 2025

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë, monitoron proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave të Kosovës. FDHK në vazhdimësi ka publikuar dhe do të publikoj analiza të rasteve dhe buletine, që do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi këto procese gjyqësore

Ky buletin paraqet të dhënat e përgjithshme mbi të gjitha aktakuzat në mungesë të ngritura për krimet e luftës nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) deri në fillim të vitit 2025.

Që nga hyrja në fuqi e ligjit për gjykimet në mungesë dhe deri në publikimin e këtij buletini (shkurt 2025), janë ngritur **pesëmbëdhjetë (15) aktakuza në mungesë kundër shtatëdhjetë e tre (73) pjesëtarëve të forcave serbe**, të cilët dyshohen për kryerjen e krimeve të luftës në Kosovë.

KRIJIMI I LEGJISLACIONIT PËR FILLIMIN E GJYKIMEVE NË MUNGESË

-Në datën 19 korrik të vitit 2019 kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), ku është mundësuar gjykimi në mungesë për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës penale, të kryera në periudhën kohore janar 1990 deri në qershor 1999.

-Në datën 18 qershor 2021 ka hyrë në fuqi ndryshim i dytë ligjor i KPPRK lidhur me gjykimet në mungesë, i cili e thjeshtësoi edhe më tej procedurën e gjykimeve në mungesë.

-Në datën 17 gusht të vitit 2022, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës" është publikuar Kodi i ri i Procedurës Penale (08/L-032). Në nenin 303 të këtij Kodi është parashikuar edhe procedura për gjykimet në mungesë për të gjitha llojet e veprave penale duke përfshirë edhe veprat penale të krimeve të luftës.

Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) për t'u ngritur një aktakuzë në mungesë fillimisht duhet të ndërmerren këto veprimet: thirrja, urdhërarrest, kërkimi i adresës së të pandehurit dhe lëshimi i letërreshtimit.

Pas ngritjes së aktakuzës në mungesë për krimet e luftës, gjykimi në mungesë mund të mbahet nëse kryetari i trupit gjykues bindet se janë plotësuar përpjekjet e arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij.

Me përpjekjet e arsyeshme kuptohet që përveç thirrjes dhe urdhërarrestit duhet të bëhet edhe një fushat informative të plotë duk e thirrur të akuzuarin të dorëzohet në juridiksionin e gjykatës.

Personi i gjykuar në mungesë ka të drejtën të përfaqësohet nga një mbrojtës sipas detyrës zyrtare dhe **të drejtën e rigjyimit të pakushtëzuar pas arrestimit.**

AKTAKUZAT E NGRITURA NË MUNGESË

Më poshtë është paraqitur shkurtimisht përmbajtja e aktakuzave dhe veprave penale me të cilat ngarkohen të akuzuarit. Disa nga të akuzuarit janë identifikuar vetëm me inicialet e tyre, pasi aktakuzat e tyre nuk janë bërë të njohura për publikun deri në momentin e publikimit të këtij buletini

RASTI: PROKURORI KUNDËR DEJAN RACIQIT

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) në datën 2 maj të vitit 2023 ka ngritur aktakuzën në mungesë kundër Dejan Raciq nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri i veshur me uniformë ushtarake të Serbisë, i armatosur me pushkë automatike dhe thikë, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht në datën 2 qershor të vitit 1999, në një fshatë të Komunës së Klinës/Klina ka kryer **dhunim seksual** ndaj gruas së nacionalitetit shqiptarë.

Më 21 shkurt të vitit 2024, është mbajtur shqyrtimi fillestar pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priştina, në mungesë të të akuzuarit, i cili përfaqësohej nga një mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

RASTI: PROKURORI KUNDËR ÇEDOMIR AKSIQIT

PSRK në datën 2 maj të vitit 2023 ka ngritur aktakuzën në mungesë kundër Çedomir Aksiq nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri në periudhën kohore në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave ushtarake dhe policore, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht gjatë periudhës janar-maj të vitit 1999, në rrethinën e Komunës së Shtimes/Štimlje, ka marrë pjesë në dëbimin, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha apo cenim të integritetit trupor ose të shëndetit dhe vrasjes së popullatës civile shqiptare.

Më 26 dhjetor të vitit 2024, pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, është shpallur aktgjykimi ku i akuzuari Aksiq është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të *krimit të luftës kundër popullatës civile* dhe i është shqiptuar dënimi me burgim prej pesëmbëdhjetë (15) viteve.

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi, i cili ende nuk ka marrë formë të prerë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR G.P.

PSRK në datën 19 maj të vitit 2023 ka ngritur aktakuzën në mungesë kundër G.P. nën dyshim se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezerve të MPB të Serbisë në bashkëkryerje me policë të tjerë, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht në periudhën korrik-gusht të vitit 1998, në një fshat të Komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje, ka kryer **dhunim seksual** ndaj një mashkulli të nacionalitetit shqiptar.

RASTI: PROKURORI KUNDËR I.B.

PSRK në datën 10 korrik të vitit 2023 ka ngritur aktakuzën në mungesë kundër I.B. nën dyshim se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i forcave ushtarake dhe policore serbe në bashkëkryerje me persona të tjerë, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në fshatin Zajm/Zajmovo të Komunës së Klinës/Klina dhe fshatrave përreth, ka kryer plaçkitjen dhe dëbimin e popullatës civile.

RASTI: PROKURORI KUNDËR IVICA RAJKOVIQIT DHE DRAGAN DENIQIT

PSRK në datën 14 shtator të vitit 2023 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër Ivica Rajković dhe Dragan Deniq nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit si pjesëtarë të forcave policore të MPB të Serbisë, në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht gjatë muajit maj të vitit 1999, në Komunën e Prishtinës/Priština, kanë marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, plaçkitjen e tyre, kanë ushtruar dhunë fizike dhe psikike ndaj tyre, dhe kanë kryer **dhunim seksual** ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptarë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR SLLAVISHA FILLIQIT

PSRK në datën 15 shtator të vitit 2023 ka ngritur aktakuzën në mungesë kundër Sllavisha Filiq nën dyshim se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i Sigurimit Shtetëror në Prishtinë - MPB në bashkëkryerje me persona të tjerë, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 10 prill të vitit 1998, në Komunën e Prishtinës/Priština ka marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e një personi, për fatin e të cilit nuk dihet ende asgjë.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje penale ka nisur më 3 dhjetor 2024 dhe aktualisht është në fazën e administrimit të provave, ku po dëgjohen dëshmitarët e propozuar nga prokuroria.

RASTI: PROKURORI KUNDËR MILLAN JOVANOVIQIT

PSRK në datën 2 tetor të vitit 2023 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër Millan Jovanović nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i forcave policore serbe në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht gjatë muajit janar të vitit 1999, në Komunën e Ferizajit/Uroševac, kanë kryer **dhunim seksual** ndaj një vajze të mitur të nacionalitetit shqiptarë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR M.S. DHE TË TJERË

PSRK në datën 7 dhjetor të vitit 2023 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër M.S. dhe të tjerë nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se pesëdhjetë e tre (53) pjesëtarë të forcave policore, paramilitare dhe ushtarake serbe, prej të cilëve gjashtëmbëdhjetë (16) ishin të pozicionuar në struktura të rëndësishme ushtarake dhe policore të Serbisë, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht në periudhën 27-29 prill të vitit 1999, në fshatrat në pjesën veri-perëndimore të Komunës së Gjakovës/Đakovica, kanë zhvilluar një operacion të përbashkët dhe të mirë organizuar të UJ-së dhe MPB-së, kanë kryer vrasje, keqtrajtme, shkatërrim të pasurisë, dëbim masive të popullatës civile shqiptarë, ku si pasojë janë vrarë treqind e shtatëdhjetë (370) civilë.

Pas kërkesës së kryetares së trupit gjykues të Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priştina, të datës 23 prill të vitit 2024, për plotësimin/përmirësimin e aktakuzës, më 23 dhjetor të vitit 2024, PSRK ka dorëzuar aktakuzën e ndryshuar kundër M.S. dhe të tjerë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR LJUBOMIR ÇIMBUROVIQIT DHE TË TJERË

PSRK datën 14 maj të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër Ljubomir Çimburoviqit, Predrag Bradiqit dhe Millivoje Iviqit nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Ljubomir Çimburoviq në cilësinë e drejtorit të Burgut të Qarkut në Prishtinë/Priştina, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht periudhës kohore 24 maj të vitit 1999 deri me 10 qershor të vitit 1999, duke pasur kontroll efektiv mbi vartësit e tij, ka qenë në dijeni dhe ka qenë prezent dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim parandalues për të ndaluar apo raportuar në hierarki gardianët e burgut duke përfshirë edhe të pandehurit Predrag Bradiq dhe Millivoje Iviq, dhe tani i akuzuari Dragisha Milenkoviq, të cilët në bashkëkryerje me zyrtarë të tjerë në burgun e Prishtinës/Priştina dhe në paralelen në Lipjan/Lipljan, kanë marrë pjesë në keqtrajtimin e të burgosurve shqiptarë në mënyrë sistematike duke i kanosur seriozisht me jetë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR S.S. DHE M.S.

PSRK në datën 29 tetor të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër S.S. dhe M.S. nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit në bashkëkryerje me pjestarë të tjerë të forcave policore, paramilitare dhe ushtarake serbe, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 6 prill të vitit 1999, në fshatin Cernicë/Cernica të Komunës së Gjilanit/Gnjilane, kanë kryer vrasje, maltretime fizike dhe psikike, plaçkitje të pasurisë, dhe dëbimin e popullatës civile shqiptare.

RASTI: PROKURORI KUNDËR Z.P.

PSRK në datën 19 dhjetor të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër Z.P. nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri i uniformuar dhe i armatosur në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave policore dhe ushtarake serbe, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 26 mars të vitit 1999, në fshatin Brestoc/Brestovac të Komunës së Rahovecit/Orahovac, ka marrë pjesë në vrasjen, plaçkitjen, dëbimin masiv dhe plaçkitjen dhe shkatërrimin e pasurisë së popullatës civile të nacionalitetit shqiptarë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR V.N.

PSRK në datën 20 dhjetor të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër N.P. nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave policore, paramilitare dhe ushtarake serbe, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 16 prill të vitit 1999, në Suharekë/Suva Reka, ka kryer vrasje, maltretime fizike dhe psikike të popullatës civile shqiptare.

RASTI: PROKURORI KUNDËR G.V.

PSRK në datën 23 dhjetor të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër G.V. nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i forcave policore në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur të forcave policore dhe ushtarake serbe, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht gjatë muajit shkurt të vitit 1999, në Komunën e Istogut/Istok, ka kryer **dhunim seksual** ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptarë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR D.G. DHE TË TJERË

PSRK në datën 30 dhjetor të vitit 2024 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër D.G., Zh.C., dhe Z.Sh. nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri D.G. si shef i Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Gjilan/Gnjilane në cilësinë e eprorit dhe duke pasur kontroll efektiv mbi vartësit e tij, ka qenë në dijeni dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim parandalues për të ndaluar apo raportuar në hierarki krimet e luftës të kryera në fshatrat Inatoc/Inatovce, Llovcë/Lovce, Pogragjë/Podgrađe dhe Uglarë/Ugljare të Komunë së Gjilanit/Gnjilane.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Zh.C. si pjesë e grupit kriminal, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 5 prill të vitit 1999, ka marrë pjesë në vrasjen, rrahjen, keqtrajtimin, torturimin, plaçkitjen dhe dëbimin e popullatës civile shqiptare të rajonit të Gjilanit/Gnjilane.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Z.Sh. në cilësinë e mjekut të Spitalit Rajonal të Gjilanit/Gnjilane, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht me datë 5 prill të vitit 1999, nuk i ofroi ndihmën e duhur mjekësore viktimës së plagosur nga forcat serbe vetëm për faktin se viktima ishte shqiptarë, dhe si pasojë e këtij veprimi viktima ndërroi jetë në të njëjtën ditë.

RASTI: PROKURORI KUNDËR C.K.


PSRK në datën 27 janar të vitit 2025 ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër C.K. nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullatës civile*, aktualisht sipas KPRK-së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri si pjesëtar i mobilizuar i forcave policore të MPB të Serbisë, në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, përkatësisht gjatë muajit prill të vitit 1999, në rrethinën e Komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, kanë kryer **dhunim seksual** ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptarë.

Prej pesëmbëdhjetë (15) aktakuzave të ngritura në mungesë, **gjashtë (6) përfshijnë akuza për dhunim seksual** ndaj civilëve shqiptarë gjatë Luftës në Kosovë.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i Drejtësisë Tranzicionale, Dialogut dhe Kuptimit të Historisë".

Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".



Federal Department of Foreign Affairs FDFA



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo